



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:101255

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733617

C.nr.1052/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësi S.K.1. nga Prizreni, kundër të paditurve S.K.2., S.M., S.K.3., R.K. të cilët i përfaqëson e paditura S.K.3. të paditurve Sh.N., Z.A. dhe N.K. tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm avokat S.M. avokat nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit 3,100 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 16.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësi S.K.1. nga Prizreni, në tërësi si e bazuar.

II. VËRTETOHET se paditësi S.K.1. nga Prizreni, në bazë të parashkrimit fitues është pronarë më $\frac{1}{2}$ e ngastrës kadastrale me numër P-7183068-..... në ZK Prizren, në pjesët e sipërfaqes në dimensionet: nga ana veriore 12.43m, nga ana jug-lindore 15.56m, nga ana jugore 6.42m dhe nga ana perëndimore 14.01, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 133 m², me sipërfaqe të përbashkët prej 2157 m², në ZK Prizren, ashtu që **DETYROHEN** të paditurit S.K.2., S.M., S.K.3., R.K. Sh.N., Z.A. dhe N.K. që paditësi t'ia pranojnë këtë të drejtë dhe t'ia lejojnë që këtë pjesë e patundshmëri ta regjistrojnë në librat kadastrale me emrin e tij si bashkëpronarë dhe atë brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi S.K.1. nga Prizreni pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padinë ndaj të paditurive K.B.dhe S.K. nga Prizreni me objekt të padisë vërtetim i pronësisë.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi në padi ka theksuar se e ka blerë pjesën e patundshmërisë me përshkrimin nr.78/2011, patundshmërinë së bashku me S.K.2. e cila evidentohet me numër të certifikatës së pronësisë P-71813068-.... e evidentuar në Zyrën Komunale më Prizren, ku në ndërkohë palët kanë ndërtuar shtëpi ku edhe jetojnë, duke shtuar se paditësi ka kërkuar nga i padituri që ta shndërrojnë gjendjen faktike në juridike sipas marrëveshjes gojore, por që i padituri S.K.2. e ka prolonguar me qëllim tjetërsimin e pasurisë dhe i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet se paditësi është pronar me $\frac{1}{2}$ të patundshmërisë e

cila evidentohet me numër të certifikatës P-71813068-05520-0 me përshkrim nr.78/2011 ZK Prizren.

Me parashtresën e datës 12.12.2022 i autorizuari i paditësit avokat D.N. ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në aspektin subjektiv, ku në cilësi të palës së paditur ka përfshirë S.M., S.K.2., S.K.3., R.K. Sh.N., Z.A. dhe N.K ndërsa në shqyrtimin e datës 12.01.2023 për shka të mungesës së legjitimitetit pasiv sipas certifikatës së pronësisë për ngastrën kontestuese ka hequr dorë nga i padituri K.B.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditësit avokat D.N. ka mbetur pranë kërkesëpadisë, duke shtuar se objekt i çështjes është vërtetimi i pronësisë, ku sipas certifikatës së pronësisë në pronën që e ka ndërtuar shtëpinë paditësi S.K.1. evidentohet bashkëpronarë të paditurit, dhe se paditësi që nga vitet e 80-ta është duke e shfrytëzuar pa penguar pjesën e ngastrës kontestues. Fjalën përfundimtare, paditësi e ka dorëzuar në formë të shkruar ku ka deklaruar se nga provat e administruara pa mëdyshje është vërtetuar se kërkesëpadia është e arsyeshme dhe e bazuar në ligj, pasi që në vitin 1972 së bashku me vëllain e tij A.K. e kanë blerë nga paraardhësit e të paditurve një pjesë të ngastrës kadastrale me nr.05520-0 që gjendet në rrugën “Bashkim Suka” në Prizren e evidentuar në sipërfaqe prej 2157m², e cila evidentohet në emër të Gj.G. Duke u mbështetur në nenin 73 të LMD-së marrëveshja gojore e lidhur ndërmjet paditësit dhe trashëgimlënësve të të paditurve është e plotfuqishme me rastin e marrjes në posedim të paluajtshmërisë. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësi ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

I padituri S.K.2. me përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit, duke propozuar që padia të refuzohet si e pabazuar për faktin se i njëjti nuk ia ka shitur paluajtshmërinë paditësit e as që ka qenë dëshmitarë kur paditësi e ka blerë këtë paluajtshmëri. Ka theksuar se është njëri nga bashkëpronarët me pjesën ideale 1/9 në paluajtshmërinë e regjistruar me numër P-71813068-..... e cila nuk është e ndarë fizikisht. Në seancën përgaditore ka deklaruar se në bazë të shkresave të lëndës e ka kuptuar se lënda është shumë kohë në gjykatë dhe se juridikisht toka lëndore është në emrin e tyre, mirëpo faktikisht nuk është e tyre që nga viti 1961, pasi që babi i tyre iu ka dhënë këtë tokë djemve V.K. dhe R.K. ku ata kanë ndërtuar shtëpinë në këtë tokë. Sa i përket pronës që e kërkon S.K.1. ka shtuar se nuk ka qenë prezent as në shitje e as në të dhënien e të hollave për tokën, ata e kanë blerë tokën, e kanë ndërtuar shtëpinë dhe të paditurve nuk iu ka interesuar kjo punë ngase nuk ka qenë prona e tyre.

E paditura S.K.3. në cilësi të të paditurës si dhe në cilësinë e të autorizuarës për të paditurin S.K.2., S.M. dhe R.K. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nuk e ka shitur tokën dhe as nuk ka pranuar të holla dhe se nuk pranon që toka të regjistrohet në emër të paditësit. Edhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar padinë pasi që nuk kanë interes juridik personalisht dhe e gjithë familja që të dëmtohen në pronë[n] e tyre. Po ashtu sa i përket shitjes ka deklaruar se as nuk e kanë shitur e as nuk kanë pranuar të holla, ndërsa sa i përket pretendimit të paditësit lidhur me regjistrimin e kësaj prone që ta fitoj të drejtën e shfrytëzimit në pronën ku vëllezërit dhe motrat (të paditurit) janë bashkëpronar, ndërsa rrugën e tyre mbrapa objekteve shtëpiake e kanë shitur gjatë viteve 2000 dhe se me këtë vërtetim të pronësisë do të krijohet një precedent edhe nga pronarët e tjerë të cilët e shfrytëzojnë pa lejen e pronarëve, ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet padia si e pabazuar.

Të paditurve Gj.G., Sh.N., Z.A. dhe N.K. me adresë të panjohur, gjykata me aktvendimin me shenjën C.nr.1052/20 të datës 31.03.2023, iu ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, avokat S.M. nga Prizreni, në përgjigjen në padi, të dorëzuar me datë 01.06.2023, e ka kundërshtuar bazën juridike të padisë dhe kërkesës së saj, duke e kundërshtuar edhe legjitimitetin real pasiv të palëve, pasi që nuk është provuar ky legjitimitet në asnjë formë, duke i propozuar gjykatës që padinë e paditësi ta refuzon si të pabazuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare i njëjti ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se është pronar i ligjshëm dhe posedues faktik i paluajtshmërisë pasi që nuk ka ofruar prova se është pronar në bazë të parashkrimit fitues, e që nuk janë vërtetuar as nga ana e ekspertit se paditësi është në posedim dhe shfrytëzim të lirë faktik të kësaj paluajtshmërie, po ashtu edhe nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse është mohuar fakti i të qenit në dijeni se paditësi nga paraardhësit e të paditurve ta ketë blerë paluajtshmërinë kontestuese para 40 viteve dhe ta ketë në posedim të papenguar dhe se pretendimi i paditësit nuk është vërtetuar edhe me shikimin në vend përmes ekspertit. Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve ka deklaruar se ka tentuar të ketë kontakt me të paditurit që të njoftohet drejtpërsëdrejti lidhur me historikun e gjendjes juridike, mirëpo nuk ka arritur që të kontaktoj. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë dhe padinë si të pabazuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare gjykata ka administruar provat si në vijim: dëgjimin e dëshmitarit A.K. leximi i certifikatës me numër 18-18428 e lëshuar me datë 03.06.2014 dhe është bërë shikimi i skicës; është lexuar ekspertiza e punuar nga ekspertja T.K. e datës 07.07.2015 dhe është bërë shikimi i skicës së terrenit; është lexuar ekspertiza dhe shikimi i skicës së terrenit dhe orto foto e punuar nga eksperti i gjeodezisë D.B. me datë 29.01.2023 si dhe dëgjimi i ekspertit në shqyrtimin e datës 16.02.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

kërkesëpadija e paditësi është në tërësi e bazuar.

Gjykata në shqyrtimin e datës 30.11.2023, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit A.K. i cili ka deklaruar se: paditësi S. është vëllai i tij. Palët e paditura janë fëmijët e axhës dhe shtëpinë e kanë përgjysmë me vëllain S. me nga një ari e gjysmë.

Nga leximi i certifikatës me numër 18-18428 e datës 03.06.2014, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale 05520-0, me sipërfaqe prej 2157 m², në vendin e quajtur Kamenica në Zonën Kadastrale në Prizren evidentohet në emër të të paditurve Gj.G., S.M., Sh.N., Z.A., Gj.K., S. K.1., R.K., S.K.2., dhe N.K. si bashkë posedues ne pjesë ideale me 1/9.

Nga leximi i ekspertizës së ekspertes T.K. të datës 07.07.2015 së bashku me skicën e bashkangjitur në ekspertizë, gjykata vërtetoi faktin se është bërë identifikimi i parcelave kadastrale me numër 5520-0 dhe 5531/1. Në pjesën juglindore të ngastrës 5520-0 është i ndërtuar objekti familjar me etazhitete P+0, objekti shtrihet edhe ne ngastrën kadastrale 10989 dhe ate e përfshin sipërfaqen prej 47 m² pjese e ngastrës 10986 (kanali) Z.K. Prizren e evidentuar në emër të psh Ujrat me kulture jopjellore e ne sipërfaqe 5161m². Paditësi në vend e shfrytëzon diku ½ të e objektit familjar dhe atë pjesën perëndimore me etazhitet P+0, në sipërfaqe prej 50m² ndërsa me kulturë oborr 57 m² që përben sipërfaqen e tërësishme prej 107 m², ku sipas shënimeve nga Drejtoria për gjeodezi dhe Kadaster në Prizren kjo ngastër është e

evidentuar në emër të bashkëpronarëve Gj.G., S.M., Sh.N., Z.A., Gj.K., S. K.1., R.K., S.K.2., dhe N.K. si bashkë posedues ne pjesë ideale me 1/9.

Nga leximi i ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë D.B. të datës 01.08.2023 së bashku me skicën e bashkangjitur në ekspertizë, gjykata vërtetoi faktin se është bërë identifikimi i parcelës 05520-0 ZK në Prizren, ku gjatë identifikimit është konstatuar se në pjesën jug-lindore të parcelës 05520-0 gjendet një shtëpi me katshmëri P+0 e cila nga ana perëndimore të saj ka hyrje – daljen në oborrin i cili është i rrethuar me mur prej bllokave të betonit, nga ana lindore e sajë njëjta ka edhe një derë e cila ka qenë e mbyllur gjatë identifikimit. Kjo pjesë e parcelës nga ana jugore e saj ka dalje në rrugën e lagjes e cila është e kubëzuar, po ashtu sipas matjeve në teren është konstatuar se pjesa e parë e parcelës e cila është objekt i kontestit ka sipërfaqe S=133m² me këto dimensione: nga ana veriore 12.43m, nga ana jug-lindore 15.56m, nga ana jugore 6.42m, ndërsa nga ana perëndimore 14.01m. Baza e objektit që gjendet në këtë parcelë është e shtrirë edhe në pjesët e parcelave nr.05531-1 dhe 10986-0 ZK Prizren. Në Zyrën kadastrale në Prizren, parcela nr.05520-0, 05531-1 ZK evidentohen në emër të të paditurve me 1/9 të pjesës ideale.

Gjykata në shqyrtimin e datës 30.11.2023, ka bërë dëgjimin e ekspertit të gjeodezisë D.B. i cili ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës dhe se pjesa e parcelës në të cilën është ndërtuar shtëpia ka sipërfaqen prej 133 m² dhe se pjesa tjetër është e shtrirë në një kanale publik siç vërehet edhe nga skica e realizuar në teren.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtarë i gjykatës.

Me nenin 1 të Protokolit shtesë së Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, parashihet se “çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interes publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Duke pasur parasysh kohën në të cilin paditësi pretendon se ishte krijuar raporti, përkatësisht paraardhësi i tyre e ka blerë ngastrën kontestuese, gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore, si ligj i zbatueshëm paraqitet të jetë Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (më tutje si LMTHJP), i cili është i zbatueshëm bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 (gazeta zyrtare e RSFJ nr.6/80). Sipas nenit 20 të LMTHJP-së, është e paraparë se “E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik, dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”, ndërsa neni 33 i po këtij ligji përcaktonte se “në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”. Neni 21 i LMTHJP liston mënyrat e fitimit të të drejtave pronësore të cilat mund të arrihen përmes ligjit, si psh: “krijimi i një sendi të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me parashkrim fitues”, ndërsa neni 28 i ligjit të lartcekur thekson se par.1 “Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh” ndërsa paragrafi 4 i po këtij neni parasheh “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Po ashtu edhe me ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nr. 03/L-154 (gazeta zyrtare Republikës së Kosovës nr.57/04 gusht 2009) i cili tani është zbatueshëm, në nenin 40

par.1, përcakton se *“Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të”*. Përfundimisht me Ligjin për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (gazeta zyrtare Republikës së Kosovës nr. 38/20 shtator 2008) me nenin 7.1 është paraparë që *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* ndërsa me nenin 319.1 të po këtij ligji parashihet që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*

Në bazë të dispozitave ligjore, rrjedh fakti se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është “i ligjshëm” nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim. Më tutje posedimi konsiderohet se është me mirëbesim, po që se mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në raste të caktuara mirëbesimi supozohet. Në lidhje me elementin e tretë që ka të bëjë me kalimin e periudhës kohore të caktuar me ligj, gjykata fillon numërimin prej ditës në të cilën zotëruesi ka fituar të drejtën e posedimit të objekti (sendit), ndërsa në këtë periudhë mund të përfshihet edhe koha kur pala paraardhëse ka mbajtur sendin si zotërues i ligjshëm dhe me pëlqim, ndërsa periudhën kohore që duhet të kalojë për fitimin e të drejtës së pronësisë e parashihet ligji (LMTHJP apo LPDS). Elementi i katërt ka të bëjë me posedimin e sendit mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, por mendon se sendi është i tij dhe nuk i përket dikujt tjetër.

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësi duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar. Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara sikur më lartë, vërtetohet se paditësi në vitin 1974 e ka blerë pjesën e patundshmërisë me përshkrimin nr.78/2011 me anë të mnarrëveshjes gojore dhe se nuk e kanë formalizuar marrëveshjen me shkrim, konkretisht e kishte blerë pjesën nga ngastrat kadastrale me numër P-71813068-.... ZK Prizren, nga këtu paraardhësi i të paditurit S.K.2., mirëpo të njëjtit nuk kishin përpiluar kontratë me shkrim për shitblerjen e bërë, mirëpo paditësi e kishte përmbushur detyrim me pagesën e bërë dhe nga ajo kohë paditësi është në posedim të ngastrave të lartcekur. Këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga dëgjimi i dëshmitarit A.K. nga Prizreni. Po ashtu edhe nga deklaratat e të paditurit S.K.2. të dhënë në seancën e datës 12.01.2023 i cili ka deklaruar se: *“ka kuptuar se lënda është shumë kohë në gjykatë dhe se juridikisht toka lëndore është në emrin e tyre, mirëpo faktikisht nuk është e tyre që nga viti 1961, pasi që babi i tyre iu ka dhënë këtë tokë djemve V.K. dhe R.K., ku ata kanë ndërtuar shtëpinë në këtë tokë. Sa i përket pronës që e kërkon S.K.1. ka shtuar se nuk ka qenë prezent as në shitje e as në të dhënien e të hollave për tokën, ata e kanë blerë tokën, e kanë ndërtuar shtëpinë dhe të paditurve nuk iu ka interesuar kjo punë ngase nuk ka qenë prona e tyre”*. Mbi këto baza gjykata konstaton se me pagesën e realizuar nga ana e paditësi S.K.1. ndaj paraardhësve të të paditurve, konstituohet mirëbesimi si kusht i parë për fitimin e pronësisë me parashkrim ndërsa fakti se paditësi dhe ka hyrë në posedim të ngastrës kadastrale kontestuse nga viti 1974 e të njëjtën e ka në posedim deri në përpilimin e padisë në vitin 2020 (mbi 45 vite) me çka mund të konstatohet se plotësohet edhe kushti i dytë afati i përcaktuar prej 20 vitesh. Gjithashtu asnjëra nga palët ndërgjyqëse në asnjë fazë të procedurës nuk e kanë kontestuar posedimin dhe mirëbesimin e paditësit. Përfundimisht gjykata konstaton se me përmbushjen e të dy kushteve të përcaktuara si më lartë në mënyrë komulative dhe atë të

mirëbesimit dhe të posedimit të pandërprerë të paditësit të ngastrës kadastrale P-71813068-05520-0 ZK Prizren, të cilat paraqesin fakte vendimtare për fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Po ashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke përcaktuar masat dhe dimensionet e pjesës së parcelave, të cilat shfrytëzohet nga këtu paditësi, duke u bazuar në ekspertizën e gjeodezisë së ekspertit D.B.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera të administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe pretendimet e tjera të palëve, por ka gjetur se të njëjtat nuk janë me ndikim në marrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenit 450 lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, pasi që pala paditëse nuk i kërkoi shpenzimet procedurale. Ndërsa për shpenzimet lidhur me përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurit, gjykata me aktvendim të veçantë e ka urdhëruar zyrën e financave të kësaj gjykate për transferimin e mjeteve në llogari të përfaqësuesit të përkohshëm.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 28.4 të LMTHJP-se lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1052/20 datë 16.02.2024

Gj y q t a r j a
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.